



# RAPORTI I PROGRESIT TË KOMPAKTIT

SHTATOR 2015

VLERËSIMI I PROGRESIT PËR PERIODËN KORRIK 2014 -KORRIK 2015

## Tabela e Përmbajtjes

|                                                                          |           |
|--------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Parathënie .....                                                         | 3         |
| Hyrje.....                                                               | 4         |
| Kompakti 2, 14 Maj 2015 .....                                            | 7         |
| <b>1. POLICIA DHE DOGANA .....</b>                                       | <b>11</b> |
| Përbërja etnike në institucionet për zbatimin e sundimit të ligjit ..... | 11        |
| Krimet ndëretnike .....                                                  | 11        |
| Inspektorati Policor i Kosovës .....                                     | 12        |
| Bashkëpunimi ndërmjet PK-së dhe Prokurorisë Publike.....                 | 13        |
| PK-ja në pjesën veriore të Kosovës.....                                  | 14        |
| Menaxhimi i kufirit .....                                                | 14        |
| Kontrolli i kufirit të gjelbër .....                                     | 16        |
| Mbrojtja e dëshmitarëve.....                                             | 17        |
| <b>2. DREJTËSIA .....</b>                                                | <b>18</b> |
| Përbërja etnike në institucionet gjyqësore të Kosovës.....               | 18        |
| Shërbimi Korrektues i Kosovës .....                                      | 19        |
| Qendra e Paraburgimit e Mitrovicës.....                                  | 21        |
| Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës.....      | 21        |
| Luftimi i korrupsionit.....                                              | 24        |
| Agjencia Kosovare e Pronës.....                                          | 26        |
| Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.....                                  | 26        |
| <b>3. ZBATIMI I DIALOGUT .....</b>                                       | <b>28</b> |
| Regjistri civil .....                                                    | 28        |
| Liria e lëvizjes .....                                                   | 29        |
| MIK.....                                                                 | 29        |
| Integrimi i strukturave të sigurisë.....                                 | 29        |
| Drejtësia .....                                                          | 29        |
| Njësia e PK për trashëgimi fetare dhe kulturore.....                     | 29        |
| Lista e akronimeve dhe shkurtesave .....                                 | 31        |



# Parathënie

Pas mandatit të ri të EULEX-it në qershor 2014, Misioni dhe Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë (PSBE)/Zyra e BE-së në Kosovë kanë bashkëpunuar ngushtë me institucionet sundimit të ligjit në Kosovë për t'u pajtuar me një 'plan të përbashkët pune', i cili do të zgjas deri në qershor 2016 – fundi i mandatit aktual të EULEX-it. Kjo ka sjellë një energji të shtuar në punën tonë të përbashkët për fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Plani i punës ishte përforcuar nga një përkushtim politik i të tria palëve me interes – autoritet e Kosovës, PSBE-ja/Zyra e BE-së, dhe EULEX-i – përmes nënshkrimit të 'KOMPAKT 2' më 14 maj 2015, duke e ri-konfirmuar përkushtimin tonë të përbashkët të cilin e kemi nënshkruar në marrëveshjen e parë të KOMPAKTIT në nëntor 2012.

Ne i vlerësojmë të arriturat e Kosovës që nga nënshkrimi i KOMPAKTIT të parë. Ky raport e konsideron meritë të ekspertëve të sundimit të ligjit të cilët janë përpjekur për arritjen e synimeve ambicioze të këtij KOMPAKTI dhe punës së zellshme të Kosovës për përmbushjen e kërkesave për procesin e liberalizimit të vizave, aspiratave për anëtarësim në BE dhe fuqizimit të sundimit të ligjit në Kosovë përmes reformave të vazhdueshme.

Por, ne gjithashtu vlerësojmë se nevojitet një progres më i madh për t'i arritur synimet tona të përbashkëta. Prandaj, ne e konfirmojmë përkushtimin tonë të fuqishëm për tejkalimin e zbrazëtirave të cilat i kemi identifikuar duke i ndarë burimet e nevojshme dhe duke e fokusuar punën tonë më tej me qëllim të arritjes së objektivave të sundimit të ligjit të cilat janë paraqitur në KOMPAKT.

Objektiv i pandashëm i Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit është sigurimi që institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë të kenë kapacitete të nevojshme kur EULEX-i ta përfundojë veprimtarinë e tij. Kjo është arsyeja pse zbatimi i të gjitha Veprimeve të Kompaktit – qëllimet për të cilat jemi pajtuar – është kaq i rëndësishëm. Njësoj, përmbushja e gjashtë udhërrëfyesve të miratuar në 2014 duhet të mbetet një prioritet meqë ata synojnë përmirësimin e fushave teknike konkrete të një rëndësie të veçantë për strukturat e sundimit të ligjit.

Një punë e rëndësishme është bërë në luftimin e ndërhyrjes politike në fushën e sundimit të ligjit. Janë bërë disa ndryshime domethënëse – ligjet e rëndësishme lidhur me gjyqësorin janë ndryshuar e plotësuar së fundi – por këtu duhet bërë më shumë. Ne do të vazhdojmë me partneritetin e ngushtë përmes Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit me qëllim të inkurajimit për një gjyqësor të pavarur.

Ministri i Drejtësisë në  
Kosovë

**Hajredin Kuçi**

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

**Enver Peci**

Përfaqësuesi Special i BE-së  
në Kosovë / Shefi i Zyrës së  
BE-së në Kosovë

**Samuel Žbogar**

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës

**Aleksandër Lumezi**

Shefi i Misionit Evropian për  
Sundimin e Ligjit në Kosovë

**Gabriele Meucci**

# Hyrje

Sundimi i ligjit gjithmonë ka qenë në qendër të marrëdhënieve në mes të BE-së dhe Kosovës. Gjatë disa viteve, EULEX-i, si dhe PSBE-ja/Zyra e BE-së, kanë siguruar një mbështetje të gjerë për Kosovën në progresin e saj drejt institucioneve të qëndrueshme, llogaridhëse, shumetnike, dhe të pavarura të sundimit të ligjit, të lira nga ndërhyrjet politike, si dhe rrugëtimit të Kosovës drejt integritit në BE.

Duke e pranuar nevojën për bashkërendim të mëtejshëm të planeve të tyre, BE-ja dhe institucionet e Kosovës janë pajtuar zyrtarisht për një numër objektivash lidhur me bashkëpunimin e tyre në çështjet e sundimit të ligjit. KOMPAKTI i nënshkruar në nëntor 2012 nga Ministri i Drejtësisë, Përfaqësuesi Special i BE-së/Shefi i Zyrës së BE-së, dhe Shefi i Misionit EULEX, u bë marrëveshje politike obliguese për këtë ndërmarrje të përbashkët. KOMPAKTI i kishte 12 objektiva specifike; ato do të arrihen përmes zbatimit të 24 veprimeve të KOMPAKTIT. Të gjitha palët janë përkushtuar për ndarjen e burimeve të nevojshme dhe për një fokusim të mëtejshëm të punës së tyre për arritjen e këtyre synimeve ambicioze.

Vazhdimi i mandatit të EULEX-it në qershor 2014 siguroi një mundësi për marrjen parasysh të arritjeve të Kosovës në përmbushjen e synimeve të KOMPAKTIT dhe plotësimin e kushteve për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën dhe aspiratat e saj për anëtarësim në BE.

Pas konsultimeve dhe marrëveshjes pasuese në nivel pune për objektivat e sundimit të ligjit të përcaktuara në mënyrë të përbashkët, KOMPAKTI 2, i nënshkruar në maj 2015, ri-konfirmoi përkushtimin politik të Kosovës për të punuar drejt synimeve të përcaktuara. Të 20 veprimet e KOMPAKTIT në dokument lidhin bashkë aktivitetet specifike dhe synimet ashtu që ato të jenë të matshme duke i përdorur standardet. Autoritetet e Kosovës, PSBE-ja/Zyra e BE-së, dhe EULEX-i çdo ditë janë duke punuar bashkë për arritjen e këtyre synimeve.

KOMPAKTI e mbështetë, por nuk i zëvendëson, punët tjera të rëndësishme të cilat BE-ja është duke i bërë në Kosovë, veçanërisht për proceset e integritit të Kosovës në BE që lidhen me sundimin e ligjit.

## *Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit*

Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit, i bashkë-kryesuar nga Ministri i Drejtësisë, Përfaqësuesi Special i BE-së/Shefi i Zyrës së BE-së, dhe Shefi i Misionit EULEX, vazhdoi të jetë forumi kryesor për diskutimin e temave të sundimit të ligjit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të KOMPAKTIT.

Në mënyrë që BPSL-ja të jetë më e efikas, termet e referencës janë korigjuar ashtu që përbërja të jetë më e vogël: në vend të përbërjes së mëhershme e cila kishte numër të madh të pjesëmarrësve, tani BPSL-ja përfshin vetëm tre bashkë-kryesues si dhe kryesuesit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, me mundësi për të ftuar persona të tjerë me interes, varësisht nga tema e agjendës. Kjo përbërje lejon një diskutim më të fokusuar dhe të hapur.

BPSL-ja do t'i mbështes përpjekjet e Kosovës për arritjen e standardeve të sundimit të ligjit të kërkuara në procesin e përafrimit me BE-në dhe themelimin e institucioneve të sundimit të ligjit që janë plotësisht funksionale dhe të pajisura me burime dhe të lira nga ndërhyrjet politike.

Për këtë qëllim, zbatimi i plotë i gjashtë udhërrëfyesve - planet dhe afatet kohore të miratuara në mënyrë të përbashkët për arritjen e objektivit - të miratuar në BPSL gjatë viteve të kaluara e që është esenciale për Kosovën që ajo t'i sjell kapacitetet e veta deri në nivelet e kërkuara për të aspiruar për në BE.

BPSL-ja po ashtu ka vazhduar diskutimin për mënyrën e adresimit të sfidave të ruajtjes së një gjyqësori të pavarur. BPSL-ja e ka themeluar një grup punues për të shikuar për mënyrat e përmirësimit. Ndonëse së fundi janë bërë ndryshime në legjislacionin e rëndësishëm të sundimit të ligjit, një punë e mëtejme është e nevojshme në praktikë.



### *Udhërrëfyesit e BPSL-së*

Mungesa e stafit ka vazhduar të jetë pengesë për udhërrëfyesit për themelimin e panelit të dytë për ankesa në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS) për çështjet e lidhura me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Mungesa e gjyqtarëve të përshtatshëm për të dyja institucionet i ka zvogëluar mundësitë e tyre të veprimit dhe të përfundimit të planeve të parapara të tyre të punës, ndërsa rekrutimi i stafit mbështetës shtesë nuk ka filluar akoma. Përkundër përpjekjeve për tejkalimin e problemit, nuk është gjetur ndonjë zgjidhje për më shumë se dy vite që nga miratimi i udhërrëfyesve.

Një progres është arritur deri diku në Njësinë për Përcjelljen e të Burgosurve të Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë. Efektet e mungesës kronike të stafit në këtë njësi pjesërisht do të mënjanojnë me integrimin e 25 ish-pjesëtarëve të Mbrojtjes Civile Serbe të cilët do të angazhohen në qendrën e paraburgimit. Mirëpo, problemet me mirëmbajtjen e automjeteve dhe mungesa e municionit - që e pengon trajnimin me armë të zjarrit - vazhdon të jetë shqetësim. Procedura për zgjidhjen e këtyre problemeve ende nuk është përfunduar.

Drejtorja për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (DMD) e Policisë së Kosovës tani ka rekrutuar staf të mjaftueshëm. Procesi final i prokurimit për të gjitha pajisjet e drejtorisë do të kryhet me marrjen e sistemit softuerik për menaxhimin e dëshmitarëve i cili do të sigurohet nga WINPRO II, një

projekt i financuar nga BE-ja në mbështetje të DMD-së. Legjislacioni dytësor për themelimin e plotë të DMD-së është hartuar, dhe BPSL-ja tani do të punojë në promovimin e shërbimeve të drejtorisë në mesin e prokurorive të Kosovës.

Hapat e parë për Departamentin e Mjekësisë Ligjore (DML) tashmë janë ndërmarrë: hapat fillestar në udhërrëfyesin për Departamentin e Mjekësisë Ligjore (DML) janë ndërmarrë: një projektligj është finalizuar nga autoritetet e Kosovës dhe i cili tani është në pritje të diskutimit në Kuvend. Ky ligj do ta shndërronte DML-në në një organ qendror të administratës shtetërore duke e bërë një subjekt ligjor të pavarur i cili i raporton direkt Ministrit të Drejtësisë. Dy antropologë mjekoligjor të angazhuar rishtazi janë duke vijuar një trajnim të specializuar, ndërsa krijimi i laboratorit toksikologjik është duke shkuar përpara: pajisjet e financuara nga BE-ja do të mundësojnë zhvillimin e metodave të testimit kuantitativ të përdorimit të drogës dhe alkoolit, duke filluar nga shtatori 2015.

Përkitazi me udhërrëfyesin për hetimet dhe ndjekjen penale të rasteve të krimeve të luftës, është arritur progres në pranimin e stafit për sektorët e krimeve të luftës për Policinë e Kosovës dhe Prokurorinë Speciale të Kosovës (PSRK), mirëpo nevojitet më shumë punë. Po ashtu, një numër i objektivave tjerë në udhërrëfyes ende nuk janë arritur. Andaj, grupi punues përgjegjës për mbikëqyrjen e këtij udhërrëfyesi të rëndësishëm së fundi ka filluar me punën e vet.



**Kopje: BORDI I PËRBASHKËT BASHKËRENDUES PËR SUNDIMIN E  
LIGJIT**

**MARRËVESHJE KOMPAKTE 2**

**Institucionet kosovare për sundimin e ligjit, Shefi i Zyrës së BE në Kosovë/  
Përfaqësuesi Special i BE dhe Misioni EULEX Kosova,**

*Duke i theksuar arritjet nga zbatimi i marrëveshjes kompakte të nënshkruar më 9 nëntor 2012 të mbikëqyrura nga Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit (BPBSL);*

*Duke e pranuar nevojën e autoriteteve kosovare për bashkëpunim efektiv me Misionin EULEX Kosova dhe PSBE/Zyrën e BE për arritjen e progresit të mëtejshëm në sektorin e sundimit të ligjit drejt përmbushjes së synimeve të dala nga marrëveshja kompakte dhe përmbushjes së kërkesave për aspiratat e Kosovës për liberalizim të vizave dhe anëtarësim në BE;*

*Duke e theksuar zotimin e institucioneve kosovare për sundimin e ligjit për t'i zbatuar strategjitë dhe planet e tyre të tanishme për avancimin e sundimit të ligjit dhe për të punuar me PSBE/Zyrën e BE dhe EULEX Kosova për avancimin e agjendës së përbashkët; duke e siguruar gatishmërinë e palëve nga fusha e sundimit të ligjit në Kosovë për t'i trajtuar sfidat përtej mandatit aktual të EULEX-it;*

*Duke e theksuar zotimin e ripërtërirë të institucioneve kosovare për sundimin e ligjit për të shënuar progres të mëtejshëm drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies dhe për të zhvilluar dhe fuqizuar një sistem të pavarur dhe shumetnik të drejtësisë dhe policisë*



dhe dogana shumetnike të lira nga ndërhyrja politike dhe korrupsioni, që i respektojnë të drejtat e njeriut, standardet e pranura ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira evropiane;

*Duke e theksuar* zotimin e tyre të përbashkët për të punuar në kuadër të kornizës së përgjithshme të politikave të BE-së të përcaktuara në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit me Kosovën, duke e përfshirë edhe studimin e fizibilitetit;

*Duke e theksuar* gatishmërinë për t'i kontribuar normalizimit të marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit dhe për të përparuar me zbatimin e marrëveshjeve të bëra deri më tani gjatë dialogut të lehtësuar nga BE-ja, si dhe të të gjitha marrëveshjeve të tjera të ardhshme nga fusha e sundimit të ligjit;

*Duke e pasur parasysh* përputhshmërinë e plotë të programeve të asistencës së Bashkimit Evropian për Kosovës me objektivat e përgjithshme, synimet konkrete dhe aktivitetet specifike të parapara në këtë *marrëveshje kompakte*;

#### **pajtohen si në vijim:**

1. Institucionet e Kosovës, të ndihmuara nga Bashkimi Evropian, mes të tjerash edhe nga EULEX Kosova, me anë të projekteve nga Instrumenti për para anëtarësim (IPA) dhe programet përcjellëse për mbështetje, e përsërisin zotimin për këto

#### **Objektiva të përbashkëta të përgjithshme në fushën e sundimit të ligjit:**

- Fuqizimi i policisë, doganës, institucioneve korrektuese dhe gjyqësore në mbarë territorin e Kosovës, përfshirë edhe në veriun e Kosovës, për të mirën e të gjitha komuniteteve;
- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve kosovare për sundimin e ligjit për trajtimin e krimeve ndëretnike, krimeve të rënda dhe të organizuara dhe të korrupsionit;
- Rritja e kapaciteteve të institucioneve kosovare për luftimin e korrupsionit, në veçanti përmes sistemit të drejtësisë penale;

- Ngritja e llogaridhënies së të gjitha institucioneve për sundimin e ligjit duke iu mundësuar institucioneve si Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës, si dhe strukturave të tjera përkatëse të brendshme, që t'i marrin përsipër në tërësi rolet e tyre në përputhje me ligjet;
- Konsolidimi i kapaciteteve menaxheriale strategjike, operative dhe organizative të institucioneve kosovare për sundimin e ligjit në drejtim të avancimit të zbatimit të legjislacionit, strategjive dhe planeve përkatëse të veprimit;
- Inkurajimi i shkallës më të lartë të përfshirjes etnike dhe barazisë gjinore në institucionet kosovare për sundimin e ligjit;
- Përmirësimi i reagimit të institucioneve kosovare për sundimin e ligjit ndaj shqetësimeve të ngritura shpesh nga ana e pakicave në lidhje me sigurinë publike, qasjen dhe transparencën;
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet organeve të prokurorisë dhe atyre për zbatimin e ligjit duke e lehtësuar një nivel më të lartë të komunikimit ndërmjet këtyre institucioneve;
- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve përkatëse për trajtimin e kërkesave pronësore të pazgjidhura;
- Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të Kosovës për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Zbatimi i marrëveshjeve të bëra në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja, përfshirë shfrytëzimin e zyrës së PSBE për lehtësimin e kërkesave për ndihmë juridike reciproke.

2. Palët nënshkruese i miratojnë veprimet nga marrëveshja e re kompakte që janë krijuar bashkërisht, të cilat i përcaktojnë aktivitetet specifike dhe synimet konkrete me rezultate të matshme në përputhje me objektivat e përgjithshme të përbashkëta në fushën e sundimit të ligjit.

3. Si pjesë e përpjekjeve për përmbushjen e këtyre objektivave të përgjithshme të përbashkëta në fushën e sundimit të ligjit, Shefi i Zyrës së BE në Kosovë/PSBE, Shefi i Misionit EULEX Kosova, Ministri i Drejtësisë, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, zotohen që të takohen rregullisht në Bordin e përbashkët bashkërendues për sundimin e ligjit për ta shqyrtuar përparimin e

arritur dhe për të rënë dakord për veprime konstruktive, praktike dhe të bashkërenduara për zgjidhjen e pengesave dhe avancimin e progresit teknik, përfshirë në fushat prioritare si në vijim:

- i) Zbatimin e veprimeve nga marrëveshja kompakte;
- ii) Kushtet e theksuara në udhërrëfyesin e BE-së për liberalizimin e vizave dhe në Raportin e progresit të Komisionit lidhur me fushën e sundimit të ligjit;
- iii) Legjislacionin lidhur me sundimin e ligjit;
- iv) Vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve në fushën e sundimit të ligjit përtej mandatit aktual të EULEX-it;
- iv) Prioritetet e reformave të renditura në rishikimin e sektorit të drejtësisë në Kosovë.

4. Institucionet kosovare, PSBE/Zyra e BE dhe EULEX Kosova e ritheksojnë zotimin e tyre të fuqishëm për tejkalimin e zbrazëtirave të identifikuara dhe për caktimin e burimeve të nevojshme dhe për përqendrimin e punës së tyre drejt përmbushjes së objektivave të përgjithshme të përbashkëta nga fusha e sundimit të ligjit që janë përcaktuar në këtë marrëveshje kompakte.

**Prishtinë, 14 maj 2015**

---

**Hajredin Kuçi**

Ministri i Drejtësisë në Kosovë

---

**Samuel Žbogar**

Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë / Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë

---

**Gabriele Meucci**

Shefi i Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

---

**Enver Peci**

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

---

**Aleksandër Lumezi**

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës

# 1. POLICIA DHE DOGANA



## Objektivat

Të përmirësohet më tej përbërja etnike në institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë;  
Të përmirësohen kapacitetet e autoriteteve të Kosovës në mënyrë që të merren me rastet e krimeve ndëretnike të bazuara në urrejtje;  
Të vazhdohet me procesin e ndërtimit të institucionit të IPK-së, dhe nxitjen e bashkëpunimit me PK-në;  
Të zhvillohet kapaciteti i PK-së për të bashkëpunuar me prokurorinë për krimet e rënda dhe krimin e organizuar;  
Të nxitet bashkëpunimi strategjik në fushën e menaxhimit të kufirit në mes të DK-së dhe PKK-së;  
Të ndihmohet PKK-ja në vendosjen e strukturave të nevojshme për kontrollin e kufirit të gjelbër;  
Të vazhdohet me implementimin e Programit të EULEX-it për mbrojtjen e dëshmitarëve në përputhje me udhërrëfyesin e BPSL-së.

## Aktivitetet dhe Rezultatet

### Përbërja etnike në institucionet për zbatimin e sundimit të ligjit

Ligji për Shërbimin Civil thotë se së paku 10% e pozitave në institucionet e sundimit të ligjit duhet të plotësohen me pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë. Në Policinë e Kosovës (PK), 16.10% e stafit i takon komuniteteve jo shumicë – 16.85% në mesin e policëve dhe 10.79% në mesin e stafit civil. Ngjashëm, në Doganën e Kosovës (DK) 13.2% e stafit janë nga komunitetet jo shumicë, siç është paraqitur në figurat në vijim. Të dyja institucionet inkurajohen të mbështeten në këto të dhëna pozitive dhe të vazhdojnë të tërheqin dhe të rekrutojnë pjesëtarë nga komunitetet jo shumicë.



### Krimet ndëretnike

Krimet ndëretnike janë njëra prej çështjeve më të ndjeshme në Kosovë. Prandaj, institucionet e sundimit të ligjit duhet të jenë më aktive në këtë çështje dhe të zhvillojnë një sistem të harmonizuar për mbledhjen e të dhënave për krimet ndëretnike. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Policia e Kosovës (PK) kanë mbetur të identifikojnë mënyrën më të mirë për përcaktimin dhe regjistrimin e krimeve dhe incidenteve potenciale ndëretnike.

KPK-ja dhe KGJK-ja ende nuk e kanë bërë standardizimin e sistemeve të tyre të regjistrimit të dhënave. Një definicion i zakonshëm i termit 'krim ndëretnik' është parakusht për përgatitjen e një kornize të unifikuar për të dhëna, e cila do të përmirësonte regjistrimin dhe monitorimin e këtyre rasteve. Prandaj, me vendosjen e një legjislacioni të duhur, gjyqtarët dhe prokurorët mund ta luftojnë më mirë krimin ndëretnik dhe krimin e bazuar në urrejtje. Për shembull, dispozita në *Kodin e Procedurës Penale të Kosovës* për rrethanat rënduese për shkak të krimit të bazuar në urrejtje (Neni 74, paragrafi 2.12) është një mjet i fuqishëm që është në dispozicion të gjyqësorit, mirëpo, deri tani ajo kurrë nuk është reflektuar në vendimet gjyqësore. Iniciativat si punëtoritë për prokurorët e Prokurorive Themelore dhe gjyqtarët e Gjykatave Themelore për shfrytëzimin më të mirë legjislacionit relevant tani janë duke u marrë parasysh.


Gjatë menaxhimit operacional të incidenteve ndëretnike, PK-ja i trajton ato në mënyrë adekuate. Mirëpo, përmirësimet janë të nevojshme në menaxhimin e të dhënave, duke e përfshirë mbledhjen e statistikave të besueshme, si dhe aftësinë për vlerësimin e rasteve të krimeve ndëretnike. Sistemi i Informacionit i PK-së, i paraqitur së fundi, e i cili i regjistron të dhënat e lidhura me krimin ndëretnik, duhet të ndihmojnë në identifikimin dhe kategorizimin e këtyre krimeve. Sidoqoftë, nuk ka policë të mjaftueshëm që janë të trajnuar për përdorimin e këtij sistemi, e as nuk ka kompjuterë të mjaftueshëm nëpër stacionet e policisë në Kosovë.

### **Inspektorati Policor i Kosovës**

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka vazhduar të ndërtohet si institucion duke e harmonizuar legjislacionin që e rregullon punën e tij. Së fundi janë miratuar pesë procedura administrative nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB); këto rregullore të reja mbulojnë temat e menaxhimit të brendshëm si, disiplina, personeli dhe dokumentet, emblema, dhe përdorimi i armëve. Ndërkohë, draft *Ligji për Pensionet e Policëve të Policisë së Kosovës dhe të Nëpunësve të Inspektoratit Policor të Kosovës me Autorizime të Policisë* është finalizuar. Drafti aktual i përfshinë nëpunësit e IPK-së që kanë autorizime të policisë, mirëpo, Ligji për PK-në duhet të rishikohet sepse ligji nuk e përcakton qartë se cilët nëpunës të IPK janë me autorizime të policisë.

Për t'u shërbyer më mirë të gjitha komuniteteve në Kosovë, IPK-ja është në proces të themelimit të tri zyrave në terren në Prizren, veri të Mitrovicës dhe Gjilan. Ky është një hap drejt decentralizimit të Drejtorisë – një proces i paraparë në planin strategjik të IPK-së, i cili po ashtu përfshinë zyrat rajonale të hetimeve në secilin rajon të Kosovës.

Bashkëpunimi në mes të IPK-së dhe Drejtorisë për Standarde profesionale të PK-së lidhur me hetimet disiplinore është i kënaqshëm. Drejtori i Përgjithshëm i zbaton të gjitha rekomandimet e IPK-së lidhur me hetimet penale, si dhe rekomandimet e përmendura në raportet nga inspektimet e kryera të IPK-së. Në statistikat vjetore të saj për vitin 2014, IPK ka raportuar se ka pranuar gjithsej 1,304 ankesa, prej të



cilave 608 i janë përcjellë Departamentit të IPK-së për Hetime Disiplinore dhe 674 i janë përcjellë Drejtorisë për Standarde Profesionale në PK. Prej 608 rasteve të përcjella në Departamentin e IPK-së për Hetime Disiplinore, 233 janë përcaktuar si dyshime për përfshirje në vepra penale, të cilat më pas i janë përcjellë prokurorisë, ndërsa 283 raste kanë rezultuar si shkelje disiplinore – 92 sish ende ishin në proces gjatë kohës së përpilimit të raportit. Në tremujorin e parë të 2015, IPK-ja i ka pranuar 550 ankesa: 249 i janë përcjellë Departamentit për Hetime Disiplinore në IPK dhe 285 në Drejtorinë për Standarde Profesionale të PK-së. Prej 249 veprave penale të hetuara nga IPK-ja, 22 sish kishin të bënin me korrupsion, 14 përfshinin keqpërdorimin e detyrës zyrtare, 5 kishin të bënin me marrjen e mitos, 2 raste ishin lidhur me falsifikimin e dokumenteve zyrtare, dhe 1 rast kishte të bënte me zbulimin e sekretit zyrtar.

Ndërsa bashkëpunimi në mes të IPK-së dhe PK-së është i kënaqshëm, bashkëpunimi në mes të IPK-së dhe Prokurorëve të Kosovës mbetet i kufizuar. Prokurorët shpesh hezitojnë të iniciojnë një rast kundër zyrtarëve të PK-së me gradë prej kapiteni e tutje. Në vitin 2014, prej 132 rasteve (duke përfshirë 48 raste të lidhura me korrupsion) me akuza penale të dërguara nga IPK-ja te prokuroritë, vetëm 28 raste janë përcjellë në gjykata nga prokuroritë. Pesë vepra penale janë hedhur poshtë në mungesë të provave, ndërsa asnjë rast ende nuk është përfunduar nga prokuroritë – 99 raste janë ende aktive.

Në janar 2015, IPK-ja ka nxjerrë një Raport Inspektimi për zbatimin e rekomandimeve të IPK-së për periudhën 2012-2013. IPK-ja i ka kryer 10 inspektime të cilat rezultuan me 84 rekomandime: 64 prej tyre janë zbatuar plotësisht, 36 pjesërisht dhe 2, për shkaqe të arsyeshme, nuk janë adresuar fare.

### ***Bashkëpunimi ndërmjet PK-së dhe Prokurorisë Publike***

Në luftën kundër krimit të organizuar, bashkëpunimi ndërmjet PK-së dhe prokurorisë është ende në zhvillim e sipër, në veçanti në aspektin e arritjes së rezultateve. Edhe pse bashkëpunimi ndërmjet dy organeve është identifikuar si njëri prej prioriteteve kryesore të *Strategjisë Nacionale të Kosovës kundër Krimit të Organizuar, Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Narkotikëve*, ende duhet të bëhet më shumë punë. Planeve të Veprimit, të cilat janë shkruar (plane të hollësishme lidhur me mënyrën e arritjes së objektivave), ju mungojnë afatet kohore dhe buxheti. Për më tepër, sistemet e të dhënave të cilat shfrytëzohen si nga PK-ja ashtu edhe nga prokurorët nuk janë harmonizuar ende: kjo do ta përmirësonte komunikimin dhe mënyrën e trajtimit të lëndëve ndërmjet këtyre dy palëve.

Në mënyrë që të identifikohen dhe vlerësohen dobësitë kryesore strukturore të bashkëpunimit ndërmjet policisë dhe prokurorisë, janë kryer një varg i inspektimeve tematike në konsultim me ekspertët e EULEX-it, të IPA-s (Instrumenti për ndihmë para anëtarësimit) dhe të projektit të binjakëzimit. Po ashtu janë mbajtur punëtori dhe seanca trajnimi që kanë pasur për qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërmjet prokurorëve dhe policisë. Këtu bëjnë pjesë: një punëtori e mbajtur në dhjetor 2014 e quajtur “Sfidat në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit dhe bashkëpunimi në Evropën Juglindore”, e cila ishte organizuar nga Prokurori i Shtetit i Kosovës; një trajnim i përbashkët për policinë dhe prokurorët lidhur me të intervistuarit njohës të viktimave të cenueshme; një punëtori për reagimin e policisë dhe të prokurorëve ndaj dhunës në familje; dhe një punëtori për hetimin e krimeve të rënda dhe të krimit të organizuar (në këtë punëtori prokurorët dhe policia u pajtuan ta krijojnë një sistem të përbashkët të prioritetit të lëndëve).

Aktualisht Policia e Kosovës dhe Prokurori i Shtetit janë duke e hartuar një doracak të përbashkët që do t'ju ndihmojë në bashkëpunimin e tyre. Dokumenti i ka pesë pjesë të cilat kanë të bëjnë me: bashkëpunimin e policisë dhe të prokurorëve, menaxhimin e dosjeve të hetimit dhe standardizimin e formularëve, masat e fshehta, hetimin e krimit të organizuar që ka të bëjë me shkeljet lidhur me drogën dhe standardizimin e hetimeve, korrupsionin në prokurimin publik.

### **PK-ja në pjesën veriore të Kosovës**

Në mënyrë që ta përmirësojnë planifikimin e PK-së në pjesën veriore të Kosovës, gjatë punës së përbashkët PK-ja dhe EULEX-i e kanë shqyrtuar identifikimin dhe analizimin e prioriteteve të komunitetit, vlerësimin e rrezikut dhe bashkëpunimin ndërmjet departamenteve dhe brenda tyre. Në mënyrë që shërbimi policor i bazuar në inteligjencë të funksionojë plotësisht në pjesën veriore të Kosovës duhet të adresohen disa fusha kryesore, siç janë: përkushtimi dhe bashkëpunimi i stafit të komandës rajonale; përshtatja e strukturës organizative; trajnimi i stafit të komandës dhe i zyrtarëve të inteligjencës; krijimi i kapaciteteve të përshtatshme analitike; dhe zgjidhja e çështjeve teknike të themelimit të plotë të SIPK (Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës).


Bashkëpunimi ndërmjet PK-së në veri dhe në jug të Mitrovicës ka vazhduar të përmirësohet, në veçanti lidhur me trajtimin e ngjarjeve specifike të cilat kanë mundësi të ndikojnë në siguri. Zyrtarët policorë nga të dy anët komunikojnë në mënyrë efektive kur është në pyetje planifikimi, por mbetet shumë për t'u bërë lidhur me çuarjen deri në fund të hetimeve: në këtë aspekt, këmbimi i informatave lidhur me aktivitetet kriminale duhet të përmirësohet. Megjithatë, vetëm në maj 2015 PK-ja i ka regjistruar pesë krime të motivuara politikisht dhe etnikisht dhe ua ka dorëzuar ato prokurorëve përkatës.

Rajoni Verior i PK-së e ka krijuar një njësi rezervë për kontrollin e turmave dhe të trazirave. Tani i ka 188 oficerë të trajnuar policorë të cilat janë pjesë e njësisë rezervë të intervenimit dhe mund ta mbështesin ERSH (Ekipin për Reagim të Shpejtë) nëse ka nevojë.

ERSH aktualisht i ka 36 pjesëtarë të cilët e kanë përfunduar trajnimin themelor dhe atë të avancuar. Rajoni Verior i PK-së e ka nisur trajnimin e avancuar për pjesëtarët e përhershëm të ERSH.

### **Menaxhimi i kufirit**

Të hyrat e mbledhura nga Dogana e Kosovës (DK) vazhdojnë të përbëjnë më shumë se 70% të buxhetit vjetor të Kosovës. Përkundër rënies së vogël në importe krahasuar me vitin 2014, të hyrat e mbledhura nga DK për gjashtë muajt e parë të vitit 2015 janë rritur për 5.52%. Megjithatë, kjo shifër është prapë pak më e ulët se objektivi tepër ambicioz prej 942 milion eurosh i caktuar nga autoritetet e Kosovës (shih grafikun). Megjithëse praktika



e zakonshme e autoriteteve të Kosovës është t'i investojë në Administratën e DK-së përafërsisht 1% të hyrave të mbledhura në mënyrë që t'i ndihmojë asaj lidhur me shpenzimet e funksionimit dhe zhvillimin e brendshëm, kjo praktikë nuk do të zbatohet këtë vit. Prandaj, pa investimin e qeverisë, DK përballet me një detyrë shumë të vështirë që ta arrijë objektivin e caktuar nga autoritetet e Kosovës.

DK së fundi kaloi nëpër një ristrukturim të brendshëm: organizimi i ri përfshin sistemin e ri për vlerësimin e stafit, klasifikimin e stafit, profilet profesionale, përparimin në karrierë dhe rekrutimin. Por, DK është duke u ballafaquar me mungesë serioze të stafit; rishikimi i stafit është vonuar shumë dhe stafi aktual zyrtar nuk është rishikuar ka pesë vjet tani. Ky rishikim i tillë do t'i ndihmojë DK-së ta bëjë përkufizimin e vendosjes së stafit dhe ta radhis atë në praktikat më të mira të BE-së. Në anën tjetër, DK i ka punësuar sërish 26 doganierë serbë të Kosovës të cilët patën dhënë dorëheqje kur Kosova shpalli pavarësinë në mënyrë të njëanshme më 2008.

DK ka lëshuar në punë një sistem doganor pa përdorimin e letrës në mbarë Kosovën i cili do ta shpejtojë zhdoganimin e mallrave – ky sistem duhet ta lehtësojë tregtinë dhe të krijojë partneritete më të afërta ndërmjet DK-së dhe tregtarëve. Po ashtu, kjo do ta mënjanojë nevojën për kontakt të drejtpërdrejtë ndërmjet agjentëve doganorë dhe zyrtarëve doganorë dhe është nënvizuar si mjet i rëndësishëm kundër korrupsionit. Njëkohësisht, kjo do t'i lirojë përafërsisht 35 oficerë doganorë të cilët tani do të vendosen në pjesët e tjera ku ka mungesë të stafit.

DK-ja, për herë të parë ka emëruar femra oficere për të punuar në ekzaminimet fizike dhe në detyrat e kontrollit në Vendkalimet Kufitare (VK) që paraqet një lëvizje pozitive drejt një barazie më të madhe gjinore në Administratën e DK-së.





Duke zbatuar praktika të përmirësuara të punës siç është plani i sistematizuar i aktivitetit, Njësia e Auditimit Pas Zhdoganimit (APZH) ka kryer një numër të auditimeve; Sektori për të Drejtat Pronësore Intelektuale dhe Industriale (DPII) ka raportuar një rritje të numrit të shenjave të regjistruara dalluese. Kjo është një mënyrë e rëndësishme e mbështetjes së ekonomisë së qëndrueshme, do me thënë duke mbledhur të hyra shtesë të padeklaruar përmes kontrollit pas importit si edhe duke i luftuar shkeljet e DPII.

Më 2014 kishte një rritje të konsiderueshme të numrit të lëndëve me të cilat ishte marrë Njësia DPII e DK-së: numri u rrit prej 163, në vitin 2013, në 300, më 2014. Vlera e përgjithshme e mallrave të përfshira ndërmjet vitit 2013 dhe 2014 u ngrit prej 984,563 € në 4,755,170 € – 153 raste janë trajtuar në gjysmën e parë të vitit 2015 duke sjellë 1,049,520 € të hyra. Kjo tregon përparim në operacionet e DK-së për luftimin e shkeljes së rregullave të DPII. Megjithatë, DPII i DK-së aktualisht ka më pak pjesëtarë se në vitet e kaluara: vetëm dy prej katër oficerëve janë duke punuar në këtë sektor për arsye se Drejtori i Përgjithshëm (DP) i DK-së i ka transferuar dy oficerët e tjerë në detyra të operacionit si pasojë e obligimeve ndaj mbledhjes së të hyrave.

| Viti                      | 2013    | 2014      | 2015*     |
|---------------------------|---------|-----------|-----------|
| Numri i lëndëve           | 163     | 300       | 153       |
| Sasia e mallrave me copë. | 733,033 | 814,736   | 86,036    |
| Vlera e mallrave në euro  | 984,563 | 4,755,170 | 1,049,520 |

\*Të dhënat përfshijnë periudhën deri në korrik 2015

Qendra Nacionale për Menaxhim Kufitar (QNMK) nuk është duke funksionuar me kapacitetin e saj të plotë dhe duhet bërë ende në mënyrë që ta arrijë këtë. Sidoqoftë, ministri i punëve të brendshme e ka nënshkruar një vendim ministror për ta krijuar një grup punues për shqyrtimin e procedurave standarde të veprimit për QNMK, në veçanti në lidhje me stafin, menaxhimin dhe funksionalitetin.

### **Kontrolli i kufirit të gjelbër**

Policia Kufitare e Kosovës (PKK) vazhdon të kryejë patrullime të rregullta përgjatë kufirit të gjelbër. Ndërkohë, bashkëpunimi ndërmjet PKK-së dhe shërbimeve policore kufitare nga vendet e rajonit (përveç Serbisë) është i kënaqshëm. Çdo muaj kryhen disa patrullime të përbashkëta/të sinkronizuara në të dy anët e kufirit. Këto patrullime ende nuk ia kanë dalë t'i zbulojnë aktivitetet kriminale, por sidoqoftë janë parandalues i dobishëm. Bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet PKK-së dhe DK-së lidhur me kufirin e gjelbër megjithatë duhet të përmirësohet duke i përkufizuar më qartë rolet dhe përgjegjësitë. Ky duhet të jetë synimi i parë i përbashkët i PKK-së dhe DK-së.

Në rajonin verior, policia dhe zyrtarët doganorë të EULEX-it i kanë organizuar disa takime me KFOR-in prej muajit janar 2015, si edhe një trajnim me PKK-në dhe DK-në për fillimin e zhvillimit të një plani operativ për patrullimet e kufirit të gjelbër/të kufirit administrativ. Vlerësimet e rrezikut të kufirit/kufirit administrativ janë duke u hartuar dhe të gjitha agjencitë përkatëse janë të përfshira në këtë proces. Plani operativ për kufijtë e gjelbër do të jetë gati kur të përfundojë njohja e terrenit.

Numri i stafit në Drejtorinë Rajonale të PKK-së është rritur. Nuk janë themeluar toga të reja, megjithatë dy togat të cilat aktualisht janë të vendosura në Leposaviq dhe në Zubin Potok janë

përforcuar edhe me 64 oficerë të cilët janë zgjedhur në nëntor 2014. Ky përforcim do të ndihmojë në rritjen e sigurisë në fushën e përgjegjësisë së Drejtorisë Rajonale të PKK-së në veri.



### ***Mbrojtja e dëshmitarëve***

Prej qershorit 2014, Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (DMD) e PK-së ka arritur shumë prej objektivave të identifikuar. DMD e PK-së tani konsideron që stafi i saj është i gatshëm nga aspekti operativ dhe është duke pritur ta fillojë detyrën e saj të parë.

Agjencitë përkatëse të Kosovë po ashtu janë marrë me legjislacionin dytësor lidhur me DMD-në: kjo ka çuar tek themelimi i marrëveshjeve teknike ndërmjet DMD të PK-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë, Agjencisë për Regjistrim Civil dhe Ministrisë së Arsimit.

Një objektiv i DMD të PK-së është lidhja e marrëveshjeve specifike bilaterale për mbrojtjen e dëshmitarëve me vendet në të ardhmen. Sidoqoftë, marrëveshjet ekzistuese teknike për bashkëpunimin e gjerë policor mund të shfrytëzohen, nëse është e nevojshme, për qëllime të mbrojtjes së dëshmitarëve.

Nën udhëheqjen e projektit WINPRO II (një projekt i IPA-s i quajtur 'Mbrojtja e dëshmitarëve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit'), është arritur përparim i konsiderueshëm në zhvillimin e një rrjeti mbarë Ballkanik të njëjësive për mbrojtjen e dëshmitarëve. Këto njësi tani takohen dy herë në vit dhe deri më tani kanë kryer disa ushtrime të përbashkëta trajnimi; marrëveshjet teknike formale për rregullimin e aktiviteteve të përbashkëta do të paraqiten në të ardhmen e afërt.

## 2. DREJTËSIA

### Objektivat

Përmirësimi i mëtejshëm i përbërjes etnike në institucionet gjyqësore të Kosovës;  
Përmirësimi i Shërbimeve Korrektuese të Kosovës (SHKK);  
Forcimi i kapacitetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës;  
Forcimi i një qasjeje pro aktive për aktivitetet kundër korrupsion;  
Plotësimi i mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës;  
Përmirësimi i përmbushjes së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.



### Aktivitetet dhe rezultatet


#### *Përbërja etnike në institucionet gjyqësore të Kosovës*

Gjyqësori ende ka nevojë ta sigurojë ekzistimin e një procesi transparent të rekrutimit në mënyrë që të mund të promovohet baraspesha etnike në mesin e stafit të tij. Statistikat lidhur me përkatësinë etnike dhe baraspeshën gjinore nuk tregojnë përmirësime të konsiderueshme pas emërimit të gjyqtarëve të rinj në qershor 2015. Megjithatë, rekrutimi i stafit gjyqësor serb që është në vazhdim e sipër, i cili është pjesë e dialogut të lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, do ta përmirësojë baraspeshën etnike në të ardhmen e afërt. Numri i plotë i gjyqtarëve tani është 351, 249 prej tyre janë meshkuj dhe 102 janë femra (14 femra më shumë se më 2014).

Prej këtij numri të përgjithshëm shtatë janë serbë të Kosovës (një më shumë se më 2014), nëntë janë boshnjakë të Kosovës, ndërsa është një turk i Kosovës dhe një ashkali i Kosovës (një më pak se më 2014). Në KPK janë tre boshnjakë të Kosovës, dy serbë të Kosovës dhe një turk i Kosovës. Si KPK-ja ashtu edhe KGJK-ja duhet të bëjnë më shumë punë në mënyrë që ta tërheqin dhe rekrutojnë stafin nga komunitetet jo-shumicë.



Megjithatë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerrë një rregullore dhe një vendim për propozimin dhe emërimin e një anëtari të KGJK-së nga kolegët në mesin e gjyqtareve femra, pavarësisht nga përfaqësimi etnik i cili mbrohet në mënyrë kushtetuese, por duke qenë në këtë mënyrë në harmoni me standardet ndërkombëtare për përfaqësim gjinor dhe me Ligjin për Barazi Gjinore.



### **Shërbimi Korrektues i Kosovës**

Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) ka filluar të punojë lidhur me luftimin e nepotizmit në institucion dhe me zvogëlimin e kontrabandës në institucionet e tij: në lidhje me këtë janë arrestuar katër pjesëtarë të SHKK-së dhe shtatë oficerë janë suspenduar së fundi.

SHKK-ja ka themeluar një trup bashkërendues për ta bërë monitorimin e rekomandimeve të nxjerra nga Inspektorati i Brendshëm (IB) i Ministrisë së Drejtësisë (MD). Ky trup ka bërë një numër të ndryshimeve pozitive në SHKK deri më tani. Këtu bëjnë pjesë nxjerrja e rregullave të brendshme për objektet e SHKK-së; rregullimi i orarit të stafit në mënyrë që të zvogëlohet nepotizmi i mundshëm dhe konfliktet duke e ndarë të gjithë personelin e identifikuar që kanë lidhje familjare dhe të cilët punojnë në ndërrimin e njëjtë; dhe duke e trajtuar çështjen e pushimit të rregullt dhe të posaçëm në të gjitha objektet e tij (përveç Qendrës Korrektuese të Dubravës ku nuk është trajtuar çështja e pushimit).



Megjithatë, SHKK ende përballlet me pengesa në ndërtimin e tij të plotë si institucion: SHKK vazhdon të përballlet me mungesë të stafit (numri i stafit është 20% nën kapacitetin e plotë të shërbimit); disa të burgosur të profilit të lartë vazhdojnë të gëzojnë trajtim preferencial; si dhe vazhdon ndërhyrja politike në SHKK. Për më tepër, vazhdon keqpërdorimi i rregullave për shtruarjen në spital të disa të burgosurve të profilit të lartë – edhe sa i përket shpeshtësisë edhe kohëzgjatjes – ndërsa disa të burgosurve ju jepet pushim i veçantë, që të dyja këto në kundërshtim me ligjin.


Në praktikat e prokurimit të SHKK-së duhet të bëhen përmirësime të konsiderueshme. Këto praktika të prokurimit shpesh janë tepër burokratike. Kjo ka çuar tek mos realizimi i një numri të tenderëve për më shumë se dy vjet tani. Si rezultat i kësaj, SHKK është duke u përballur me probleme të logjistikës në përgjithësi, kryesisht me mungesë të automjeteve për përcjellje, çështjet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e parkut të automjeteve, si edhe me problemet e pajisjeve të këqija apo të prishura.

Inspektorati i Brendshëm i MD ka përfunduar hartimin e planit të punës për vitin 2015, i cili bazohet në prioritetet afatmesme të cilat autoritetet e Kosovës i kanë caktuar për vitin 2015-2017, në Planin për Zhvillim Strategjik 2012-2016 dhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2014. Inspektorati i Brendshëm vazhdimisht është duke kryer vizita në terren dhe duke e monitoruar zbatimin e rekomandimeve të cilat i ka paraqitur në planin e punës.

Inspektorati i Brendshëm ka zbuluar një numër të parregullsive disiplinore që kanë të bëjnë me kontrabandën nga ana e të paraburgosurve dhe/ose të burgosurve në të gjitha institucionet e tij (përveç Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë). Problemi është në veçanti i theksuar në Qendrën Korrektuese të Dubravës, prandaj Inspektorati i Brendshëm ka nxjerrë një numër të rekomandimeve për t'u marrë me çështjen e kontrabandës – shumica e këtyre rekomandimeve

janë zbatuar. Inspektorati i Brendshëm e ka identifikuar një problem tjetër me të cilin duhet marrë, kësaj here lidhur me mënyrën e vlerësimit të nevojave dhe të rrezikshmërisë së të burgosurve. Kjo është posaçërisht e shprehur në transferimin e të burgosurve ndërmjet regjimeve të tyre (themelor, standard, i avancuar) dhe pastaj në institucionet gjysmë të hapura.

SHKK është duke i transferuar gradualisht të burgosurit në Burgun e Siguri së Lartë (BSL) të Kosovës. Numri i të burgosurve në institucion është duke u rritur për çdo muaj. Kjo do të thotë që SHKK tani i ka plotësuar obligimet e nevojshme ligjore për rivendosjen e të burgosurve në regjimet e tyre përkatëse ashtu siç parashihet me procesin e vlerësimit të rrezikshmërisë dhe të nevojave të sipërpërmendura të burgosurve.



Ky është një hap drejt krijimit të planifikimit të dënimit, në bazë të cilit mund të përcaktohen aktivitetet e të burgosurve. Sidoqoftë operacionet e përditshme të BSL janë të kufizuara për shkak të mungesës së personelit në institucion: aktualisht janë rreth 130 pjesëtarë të stafit korrektues që nuk mjafton për menaxhimin e numrit aktual të burgosurve në BSL (në fund të korrikut 2015 ishin 119 të burgosur). BSL ka nevojë edhe për 70 pjesëtarë të tjerë të stafit korrektues.

### **Qendra e Paraburgimit e Mitrovicës**

Qendra e Paraburgimit e Mitrovicës është duke funksionuar relativisht mirë përkundër mungesës së stafit të mjaftueshëm, e cila është e dukshme në veçanti në lidhje me Njësinë për Përcjelljen e Dëshmitarëve (NJPD) meqë numri i përcjelljeve që duhet t'i bëjë është duke u rritur. Rekrutimi i fundit i 25 pjesëtarëve të rinj të stafit nga komuniteti serb, si rezultat i dialogut të lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, duhet ta zvogëlojë trysninë e shkaktuar nga mungesa e stafit. Ndërkohë, nevojitet më shumë trajnim për stafin korrektues, ka mungesë të pajisjeve të përshtatshme dhe stafi shqiptar i Kosovës – të cilët e lëshuan institucionin në shkurt 2008 pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga ana e Kosovës – ende nuk është rikthyer në pozitë të mëparshme.

### **Këshillit Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës**

Zhvillimi i KGJK-së dhe i KPK-së ka bërë përparim të ngadalshëm. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të vonesave në formimin e qeverisë prej qershorit deri në dhjetor 2014. Për më tepër, më 31 gusht 2014 KGJK-ja humbi kuorumin e saj për mbajtjen e seancave pas skadimit të mandateve të dy anëtarëve ndërkombëtarë (gjyqtarë të EULEX-it). Si rezultat i kësaj, KGJK nuk ishte në gjendje t'i kryejë funksionet e saj deri në fillim të marsit 2015. Mungesa e kuoromit nënkuptonte që nuk mund të aprovohej legjislacioni aq shumë i nevojshëm, si rregullorja për përdorimin e gjuhëve

zyrtare dhe ajo për bazën e të dhënave për mbajtjen e evidencës për personat e dënuar. Kjo po ashtu kishte ndikim në kapacitetin e KGJK-së për rekrutimin, transferimin, ngritjen në pozitë dhe vlerësimin e gjyqtarëve.

Pas emërimit të tre anëtarëve të KGJK-së nga ana e Kuvendit të Kosovës, të cilët nevojiteshin për formimin e kuorumit në shkurt 2015, KGJK më në fund filloi punën dhe publikoi 48 vende të lira pune për gjyqtarët serbë të Kosovës si pjesë e ri-integrimit të gjyqësorit në veri të Kosovës. Në prill 2015, KGJK i rekomandoi 41 gjyqtarë të rinj të gjykatës themelore, më shumë se një vit pas publikimit të vendeve të lira të punës. Ngjashëm, në qershor 2015 KGJK më në fund rekrutoi shtatë kandidatë për tetë pozitat e lira në Gjykatën e Apelit – procesi i zgjedhjes kishte mbetur pezull prej janarit 2014.



Në prill 2015 KGJK aprovoi *Rregulloren për Bazën e të Dhënave për Mbajtjen e Evidencës të Personave të Dënuar*, duke e sjellë Kosovën më afër plotësimit të kushteve të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave. Muajin e njëjtë, KGJK aprovoi *Rregulloren për Zgjedhjen e Anëtarëve të KGJK-së nga Gjyqësori*, të cilës i ishte dhënë prioritet për t'iu shmangur problemeve me mungesën e kuorumit në Këshill. Më 15 qershor 2015, u publikua një pako e ligjeve e lidhur me gjyqësorin, përfshirë *Ligjin për Gjykatat, Ligjin për KGJK-në, Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe Ligjin për KPK-në*. MD, në konsultime me KGJK-në dhe KPK-në – dhe me mbështetjen e drejtpërdrejt dhe të vazhdueshme të Bashkimit Evropian – bëri përpjekje të mëdha për ta përfunduar këtë pako të ligjeve. Këto ligje kryesisht u morën me rekomandimet e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave dhe me qëllimin që të punojnë në harmoni me njëra tjetrën, në veçanti lidhur me emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe me mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit.

Si rezultat i ndryshimeve në legjislacion, KGJK dhe KPK duhet ta aprovonë një numër të akteve nënligjore, brenda gjashtë muajve prej datës së aprovimit të pakos prej katër ligjeve. Megjithatë, KGJK-së dhe Komisionit të tij për Çështje Normative ju mungon kapaciteti dhe burimet e mjaftueshme për hartimin në mënyrë të pavarur të rregullores që burojnë nga këto ligje. Kjo ishte e qartë gjatë hartimit të rregullores që ka të bëjë me zgjedhjen, suspendimin dhe shkarkimin e kryetarëve të gjykatave dhe të gjyqtarëve mbikëqyrës. Në këtë aspekt nevojitet rritja e kapaciteteve dhe e burimeve të KGJK-së.

Një pilot projekt për zhvillimin e bazës së të dhënave për mbajtjen e evidencës për personat e dënuar u lëshua më në fund në korrik 2015 në degën në Lipjan të Gjykatës Themelore të Prishtinës (GJTH). Projekti është pjesë e projektit të IPA-s "Mbështetje për KGJK-në dhe KPK-në." Baza e të dhënave do t'i përfshijë të gjitha dënimet e shqiptuara nën juridiksionin e degës prej vitit 1999.

Më 2014, Komisioni i KGJK-së për Vlerësimin e Përbushjes vlerësoi 39 gjyqtarë të cilët aplikuan për ngritje në pozitë në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, si edhe pesë gjyqtarë mandatat tre-vjeçare të cilëve kishin skaduar. Megjithatë, emërimi i tyre u desh të priste deri sa KGJK të kishte anëtarë të mjaftueshëm për arritjen e kuorumit. Më 2015, KGJK vlerësoi përbushjen e 92 gjyqtarëve, të cilëve ju kishte skaduar mandati fillestar tre vjeçar.

Për sa i përket KPK-së, në mars 2014 është shpallur konkursi për kryeprokuror të ri të shtetit për zëvendësimin e kryeprokurorit të atëhershëm të shtetit, Ismet Kabashi, i cili kishte për të dalë në pension. Më 7 qershor 2014, Aleksandër Lumezi ishte propozuar si kandidat, çka ishte në përputhje me rregulloren për përzgjedhjen e kryeprokurorit të shtetit, e miratuar në mars të atij viti. Megjithatë, më 8 korrik, Gjykata Kushtetuese e urdhëroi KPK-në që ta përsëriste procedurën e zgjedhjes, për shkak të vërtetimit të shkeljes së të drejtës për procedurë të drejtë. Por KPK-ja kishte vendosur që ta përsëriste tërë procedurën e përzgjedhjes. Në gusht, si masë e përkohshme, Sylë Hoxhaj, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore të Prizrenit, ishte zgjedhur si ushtrues i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Procedura e përsëritur e përzgjedhjes zgjati disa muaj për shkak të ri-hartimit të rregullores përkatëse dhe për t'iu përgjigjur kërkesave që ishin parashtruar nga Gjykata Kushtetuese. Përfundimisht, më 21 prill 2015, Presidentja e Kosovës e caktoi kandidatin e emëruar nga KPK-ja, Aleksandër Lumezin. Përveç rrezikut ndaj qëndrueshmërisë institucionale, mungesa e zgjatur e Kryeprokurorit të Shtetit pati ndikim mbi mundësitë vendimmarrëse të KPK-së. Kjo situatë shkaktoi vonesa në vlerësimin e performancës, raportimin e rregullt, mbajtjen e takimeve të KPK-së, dhe në funksionimin e grupeve të punës dhe komisioneve.

Në gjysmën e dytë të vitit 2014, Presidentja e Kosovës nënshkroi 21 dekrete për caktimin e prokurorëve nëpër prokurori themelore në Kosovë, ku 22 kandidatë ishin propozuar nga KPK-ja. Më vonë, në KPK u shpallën konkurse për pranimin e 18 prokurorëve për prokuroritë themelore të Kosovës. Megjithatë, propozimet e vetëm 13 prej kandidatëve u dërguan nga KPK-ja tek Presidentja, kështu që pesë pozita kanë mbetur të zbrazura. KPK-ja shpalli edhe 15 vende të reja të lira në të gjitha nivelet, përfshirë 9 pozita në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, si pjesë e ri-integrimit të stafit gjyqësor serb në Kosovën veriore. KPK-ja po ashtu shpalli vende të lira të brendshme për tre prokurorë në Prokurorinë e Shtetit dhe për tre prokurorë në PSRK. Në kohën e përpilimit të këtij raporti, kandidatët për pozitat në PSRK gjenden në fazën e intervistimit, ndërsa procedura e punësimit në Prokurorinë e Shtetit ka përfunduar. Megjithatë, procedura aktuale për caktimin dhe avancimin e prokurorëve në pozita më të larta duket se nuk është zbatuar.




Në shtator 2014, KPK-ja miratoi një raport të Komisionit për vlerësimin e performancës në të cilin u vlerësuan 27 prokurorë, por Komisioni nuk i kishte vlerësuar 35 prokurorë me mandate të përhershme. Gjatë 2015, nga Komisioni kërkohet që ta vlerësoi performancën e 88 prokurorëve, duke i përfshirë edhe 35 prokurorët e cekur më lartë, të cilët është dashur të vlerësoheshin në vitin 2014. Aktualisht, 34 prokurorë janë vlerësuar. KPK-ja duhet ta përmirësoi procesin e vlerësimit të performancës së prokurorëve të vet, dhe që këtë proces ta zhvilloi sipas rregullave ekzistuese.

Në aspektin e legjislacionit, KPK-ja ka punuar për hartimin e amandamenteve për *Ligjin për prokurorin e shtetit*, *Ligjin për KPK-në*, dhe për një sërë rregulloresh lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të KPK-së, përgjegjësinë e tyre disiplinore, funksionimin e brendshëm të prokurorive dhe barazinë etnike dhe gjinore.

### **Luftimi i korrupsionit**

Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) ka treguar progres të kufizuar për sa i përket performancës së saj të përgjithshme. Në vitin 2014, në AKK janë procesuar 304 raste, ku 131 prej tyre janë përcjellë për në prokurori apo polici për hetime të mëtejme. Prej këtyre rasteve, 101 kishin të bëjnë me mos-deklarim apo deklarim të rremë të pasurisë, 19 kishin të bëjnë me shpërdorim të pozitës zyrtare apo autoritetit, një rast kishte të bëjë me përvetësim në detyrë dhe një me marrje të mitos. Megjithatë, në lidhje me AKK-në ekzistojnë mangësi të rënda, në veçanti për sa i përket mandatit të saj për hetimin e rasteve kryesore të korrupsionit. Përveç 101 rasteve të mosdeklarimit apo deklarimit të rremë të pasurisë, në vitin 2014



AKK-ja e ka përcjellë për në prokurori numrin më të ulët të rasteve kryesore të korrupsionit (30) që nga kur ka filluar punën në shkurt të vitit 2007. Këto shifra, të publikuara në raportin vjetor të AKK-së, tregojnë se Agjencia nuk ka prodhuar rezultate domethënëse në aspektin e zbatimit të ligjit. Me qëllim të përmirësimit të mundësive të AKK-së për zhvillim të hetimeve paraprake të rasteve kryesore të korrupsionit, hetuesit e Agjencisë e kanë vijuar një seminar në prill 2015, ku qëllimi i tij ishte që të identifikohen mangësitë dhe të vijohen trajnime të përshtatura rreth teknikave të zhvillimit të hetimeve dhe rreth përpilimit të raporteve.

Në lidhje me mandatin e saj për parandalimin e korrupsionit, në vitin 2014 në AKK janë dorëzuar gjithsej 5103 deklarata të pasurisë, që përkthehet në një nivel të përgjithshëm të përputhshmërisë me 98.21% (numri i deklarimeve të pritura ishte 5196). Për sa i përket deklarimeve vjetore të pasurisë, niveli i përputhshmërisë ishte 99.74% (3038 deklarata të dorëzuara), pasuar me deklaratat në fillim të detyrës (96%; 1052 deklarata), dhe deklaratat e pasurisë pas përfundimit të detyrës apo largimit nga detyra (94%; 1018 deklarata). Niveli i përputhshmërisë për deklaratat që janë dorëzuar me kërkesë të Agjencisë ishte 100% (88 deklarata). Agjencia ka kryer kontroll

paraprak si dhe të plotë të 20% të gjitha deklaratave që i janë dorëzuar AKK-së, ashtu siç kërkohet me ligj. Gjatë kontrollit paraprak, janë vërejtur gabime domethënëse në deklaratat e zyrtarëve të lartë publikë të cilët kishin deklaruar për pasuritë e veta për herë të parë. Aktualisht nuk ekziston ndonjë proces i verifikimit i cili do ta qartësonte vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara, dhe gjithashtu ka edhe probleme me identifikimin e institucioneve me të cilat Agjencia bashkëpunon lidhur me procesin e verifikimit. AKK-ja duhet ta ketë mundësinë e përcaktimit të vlerës së vërtetë monetare të pronës së deklaruar. Numri i dënimeve për mos-deklarim apo për deklarim të rremë të pasurisë, si dhe sanksionet e shqiptuara, vazhdojnë të mbeten të ulëta.

Për sa i përket bashkëpunimit ndërinstytucional, AKK-ja, në dhjetor të vitit 2014 prokuroritë dhe PK-ja kanë nënshkruar memorandum të mirëkuptimit për përmirësimin e komunikimit dhe bashkërendimit me rastin e hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve që kanë të bëjnë me korrupsion. Po atë muaj, AKK ka organizuar në varg aktivitete informuese në Ditën ndërkombëtare kundër korrupsionit (9 dhjetor), me qëllim fuqizimin e personave për raportim të korrupsionit.

*Projektligji për amandamentimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik* ka nevojë që të harmonizohet me praktikat më të mira të BE-së. Çështja e zyrtarëve publikë që, për shembull, ushtrojnë aktivitete shtesë të shumëfishta, duhet të rregullohet me qartësi: AKK-ja duhet të ketë mundësinë e identifikimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së të gjitha konflikteve mes interesave private dhe detyrave publike të zyrtarëve publikë. Çështjet e tjera të cilat kanë nevojë të trajtohen përfshijnë: harmonizimin dhe zgjerimin e legjislacions që ka të bëjë me aktivitetet e ndaluara dhe mospërputhshmëritë e zyrtarëve të lartë; forcimin e kufizimeve pas përfundimit të punësimit; dhe prezantimin e një koncepti gjithëpërfshirës të 'konfliktit të interesit' – kjo duhet të përkufizohet mirë dhe të dalloj prej 'mospërputhshmërive'. Gjatë një konsultimi publik të mbajtur me kërkesë të Kuvendit në korrik 2015, është rënë dakord se është tejet e rëndësishme që ligji t'i respektojë standardet e cekura më lartë.

Për sa i përket sistemit disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët që kanë shkelur legjislacionsin e zbatueshëm apo kodin e etikës, këtu mund të vërehen përmirësime në aspektin e menaxhimit të këtyre rasteve disiplinore, si dhe në kornizën që e rregullon sistemin disiplinor. Në mënyrë që të sigurohet prania e kuorumit të KPK-së për marrjen e vendimeve disiplinore të shkallës së dytë, është amandamentuar legjislacioni përkatës dhe është shtuar numri i anëtarëve të KPK-së. Përveç këtyre, janë miratuar edhe dispozita për parashkrimin e rasteve disiplinore, si dhe janë miratuar afate kohore për fillimin e hetimeve disiplinore dhe janë caktuar kompetencat e KPK/KGJK lidhur me vendimet në lidhje me apelet. Megjithatë, ka ende çështje të tjera që duhet të trajtohen, siç janë parimet e përgjithshme për procedurën disiplinore, përkufizimi i sjelljeve të gabuara, dhe mundësia e refuzimit të procedurave disiplinore në bazë të kriterit të papranueshmërisë. Gjithashtu, *Ligji për prokurorin disiplinor* dhe një numër aktesh nënligjore ende presin të miratohen.

*Plani i veprimit për shtimin e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftën kundër korrupsionit* është publikuar në nëntor 2013. Megjithatë, sipas vlerësimeve paraprake, nga 959 rastet e regjistruara, vetëm 401 (41.81%) janë zgjidhur gjatë vitit të parë të hyrjes në fuqi të planit të veprimit – më shumë se gjysma e atyre rasteve janë hedhur poshtë. Prokuroritë themelore në Prishtinë dhe Mitrovicë kanë pasur nivelet më të ulëta të suksesit për sa i përket përmbushjes së detyrimeve që parashihen

me planin e veprimit, me 17.41% dhe 31.25% të rasteve të zgjidhura përkatësisht. Megjithatë, janë duke u zhvilluar hetime disiplinore, dhe janë shqiptuar sanksione kundër prokurorëve për neglizhencë apo mos-përbushje të detyrimeve të parapara me planin e veprimit.

Ekzistojnë strategji specifike për bashkëpunim institucional në luftën kundër korrupsionin, por zbatimi i tyre jo gjithnjë mbështetet nga palët e përfshira. Për shembull, memorandum i mirëkuptimit i nënshkruar mes institucioneve të vendit, ku përfshihen KPK-ja, KGJK-ja, dhe MD-ja, ka shpjerë në themelimin e Koordinatorit Kombëtar kundër Krimeve Ekonomike (KKKE), mandati i të cilit është trajtimi i rasteve të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe të evazionit fiskal. Puna e KKKE-së dhe institucionet me të cilat ai duhet të bashkëpunojë janë të përcaktuara më saktësisht në një rregullore të KPK-së. Ndonëse bordi i KKKE tani më ka filluar të funksionoi, rekomandimet që dalin nga ai shpesh nuk zbatohen për shkak të vështirësisë për zbatimin e tyre.

### ***Agjencia Kosovare e Pronës***

Komisioni i Kosovës për Kërkesa Pronësore (KKKP) dhe Paneli për Ankesa i Gjykatës Supreme për çështje të APK-së, të dy organe këto të përbëra prej punonjësve vendase dhe nga EULEX-i, kanë vazhduar me zgjidhjen e kontesteve që përfshijnë prona të paluajtshme bujqësore, komerciale dhe banesore, nga periudha e konfliktit të armatosur i viteve 1998-1999. Deri në fund të prillit 2015, KKKP-ja ka finalizuar gjithsej 42,000 kërkesa, që shënon përbushjen e suksesshme të mandatit të vet.

Paneli për Ankesa i AKP-së bën gjykimin e ankesave të parashtruara kundër vendimeve të KKKP-së lidhur me kërkesat pronësore të paraqitura para AKP-së. Deri në korrik 2015, paneli i ka gjykuar 699 ankesa, ndërsa 447 ankesa janë në pritje (disa prej tyre janë në pritje të përkthimit të dosjeve).


Sa i përket ndërlíkueshmërisë së vendimeve, në fillim të vitit 2013 në BPBSL është rënë dakord që të themelohet një panel i dytë i ankesave në AKP. Megjithatë, nuk është gjetur asnjë gjyqtar i dytë kosovar për ta bërë të mundur këtë panel të dytë. Për shkak të kufizimeve të mandatit të panelit, në mesin e gjyqtarëve kosovarë ekziston mungesë e gatishmërisë për të aplikuar për këtë pozitë. Në qershor 2014, autoritetet kosovare i dhanë fund sistemit rotativ të përfshirjes së gjyqtarëve vendas në Gjykatën Supreme.

Shumica e ankesave që paraqiten para panelit janë konteste mes grupeve të ndryshme etnike (shqiptarë të Kosovës/serbë të Kosovës), andaj zgjidhja e këtyre ankesave kërkon punë kërkimore të gjerë. Si rezultat, finalizimi i ankesave që paraqiten para panelit të apelit në AKP deri në fund të qershorit 2016 duket të mos jetë i mundur: përveç rasteve që janë në pritje, një numër i madh i vendimeve të KKKP-së ende nuk i janë dorëzuar palëve dhe ato kanë mundësi që edhe të apelojnë.


### ***Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme***

Gjyqtarët e EULEX-it dhe gjyqtarët vendas kanë vazhduar me gjykimin e rasteve nëpër trupa gjykues të përzier në DHPGJS. Në të gjithë këta trupa gjykues, gjyqtarët vendas kanë qenë në shumicë. Trupat gjykues të DHPGJS -së i shqyrtojnë paditë lidhur me privatizimet, listat e punëtorëve, paditë pronësore, paditë lidhur me likuidimet, dhe lidhur me riorganizimet. Panelet e apelit i shqyrtojnë apelet kundër vendimeve të Dhomës së Posaçme dhe apelet kundër vendimeve të gjykatave të tjera.

Nga qershori 2014 deri në qershor 2015, numri i përgjithshëm i rasteve në pritje para DHPGJS është ngritur në 20,460 – ose për 33%, siç mund të shihet në grafikun në të djathtë. Arsyeja kryesore për ngritjen e numrit të rasteve të pazgjidhura është numri i madh i rasteve të reja. Në DHPGJS çdo ditë vijnë raste të reja, shumë më shume sesa që mund të përbyllen brenda të njëjtës periudhë kohore. Përveç kësaj, është



e vështirë të parashihet numri i rasteve që do të sillen para DHPGJS -së. Kjo ndodhë pjesërisht për shkak se zyra juridike që i ofron shërbime profesionale Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)



lidhur me procedurat e likuidimit (kur ndërmarrja shuhet ndërsa pasuria rishpërndahet) është shumë aktive. Palët e dëmtuara nga këto procedura të likuidimit, si dhe nga procedurat e tjera të AKP-së, kërkojnë drejtësi nga DHPGJS-ja. Siç mund të shihet nga diagrami në anën e majtë, rastet e reja të regjistruara janë shumë më të larta krahasuar me rastet e përbyllura.

Gjatë tri viteve të fundit (qershor 2012 deri qershor 2015), në DHPGJS janë përbyllur mesatarisht 2742 raste në

vit. Duke i pasur parasysh sfidat aktuale, nuk është e mundur që të arrihet ndonjë përmirësim i nivelit të përgjithshëm të përbylljes. Për shembull, këtu përfshihen kohë të gjata të procesimit – për shkak të cilësisë jo të duhur të padive dhe parashtrësive që dorëzohen në DHPGJS– si dhe kohëzgjatja e dërgimit të parashtrësive të gjykatës tek palët që jetojnë jashtë Kosovës (në veçanti në Serbi, për shkak të sfidave lidhur me ndihmën juridike reciproke). Për më tepër, gjykata nuk ka gjyqtarë të mjaftueshëm. Kjo e tëra rezulton me ngarkesë të madhe të punës. Aktualisht, secili gjyqtar i ka nga përafërsisht 1000 raste të caktuara. Për shkak të mungesës së fundit të kuorumit në KGJK, caktimi i dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe ripërtëritja e mandateve të tre gjyqtarëve vendas nuk kanë mundur të procesohen me kohë. Vendet e lira për dy gjyqtarë vendas ende nuk kanë mundur të plotësohen. Me dispozitat procedurale aktuale në DHPGJS, thjeshtë mos-caktimi jo vetëm se e bën joaktiv gjyqtarin, por edhe tërë trupin gjykues (në shkallë të parë), pa paraparë asnjë mundësi për zëvendësim të përkohshëm. Pjesëmarrja e gjyqtarëve të DHPGJS-së në diskutime gjyqësore në seancat e përgjithshme të Gjykatës Supreme, siç kërkohet me ligj, ende nuk është mundur, për shkak të mungesës së komunikimit mes Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës për Dhomën e Posaçme. Kjo gjë ka ndikim të tërthortë në nivelin e përbylljes së rasteve, meqë gjyqtarët e DHPGJS-së nuk mund t'i diskutojnë çështjet e tyre në seancat e përgjithshme.

Duke i pasur parasysh faktorët e shumtë që ndikojnë në gjykimin e rasteve, performanca e gjykatës është vështirë të vlerësohet në afat të mesëm.

## 3. ZBATIMI I DIALOGUT

### Objektivat

Në kuadër të kornizës së Kompaktit, Zyra e BE-së dhe EULEX-i do t'i mbështesin autoritetet e Kosovës për zbatimin e marrëveshjeve të dala nga dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit lidhur me regjistrin civil, lirinë e lëvizjes, menaxhimin e integruar të kufirit, ndihmën juridike reciproke, integrimin e strukturave të sigurisë, drejtësinë dhe Njësinë e PK-së për trashëgimi fetare dhe kulturore.

### Aktivitetet dhe rezultatet

#### *Regjistri civil*

Pas kopjimit dhe vërtetimit të librave amzë civilë dhe fetarë të lindjeve, martesave dhe vdekjeve, të cilët mbahen në Serbi, dhe dorëzimit të kopjeve të vërtetuara tek Agjencia e Kosovës për Regjistrim Civil (ARC) në mars të vitit 2014, aktivitetet janë përqendruar në themelimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të besueshëm të gjendjes civile.

Përdorimi i librave amzë civilë në zyrat komunale të gjendjes civile është monitoruar me kujdes. Nga monitorimi janë vërejtur një sërë sfidash, në veçanti mungesa e një qasje të përbashkët për përdorimin e librave. Si rezultat, EULEX-i e ka organizuar një seminar për analizimin e dallimeve gjatë përdorimit të kopjeve të vërtetuara që janë identifikuar dhe që kanë nevojë për qasje të harmonizuar në të gjitha zyrat për gjendje civile në Kosovë. Rezultati i seminarit ishte nevoja e qartë për procedura të brendshme të përbashkëta lidhur me përdorimin e kopjeve të vërtetuara në pajtueshmëri me udhëzimet administrative.

Ministria e Punëve të Brendshme ka nënshkruar gjashtë marrëveshje bashkëpunimi për ndërveprimin e bazave të dhënave, dhe atë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës, Njësinë për Inteligjencë Financiare në Ministrinë e Financave, Prokurorinë e Shtetit të Kosovës, dhe Administratën Tatimore të Kosovës. Ndërveprimi i bazave të dhënave kërkon krijimin e lidhjeve mes bazave të dhënave dhe integrimin efektiv të dhënave në një bazë qendrore të dhënave për gjendjen civile. Përveç njëres, të gjitha marrëveshjet e tjera presin zbatimin në praktikë. Është me rëndësi që të gjitha të dhënat personale që janë të regjistruara nëpër librat amzë të gjendjes civile, përfshirë në kopjet e vërtetuara, të regjistrohen në format elektronik i cili mundëson kërkime të gjithanshme duke i përdorur të dhënat që janë në dispozicion, dhe që të gjitha bazat e të dhënave që përmbajnë të dhëna personale të lidhen me një sistem të centralizuar të regjistrimit të gjendjes civile.



## ***Liria e lëvizjes***

Si pjesë e zbatimit të marrëveshjes për liri të lëvizjes, në qershor të vitit 2015, Byroja Kosovare e Sigurimit dhe Shoqata për Sigurime e Serbisë kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi për njohje reciproke të sigurimeve për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, i cili ka hyrë në fuqi më 12 gusht 2015. Sipas marrëveshjes, përdoruesit e mjeteve motorike që janë të regjistruara në territorin e njëres palë dhe të cilat kanë sigurim të vlefshëm për territorin e palës tjetër, mund të hyjnë lirshëm dhe të udhëtojnë në atë juridiksion.

## ***MIK***

Në këtë fushë është arritur progres i rëndësishëm. Pas negociatave mes Prishtinës dhe Beogradit, të lehtësuara nga BE-ja, ka rifilluar grumbullimi i të hyrave doganore në pikë-kalimet veriore, është themeluar regjimi i licencimit edhe për ndërmarrjet nga Kosova veriore të cilat importojnë produkte të kontrolluara, dhe mes Kosovës dhe Serbisë është rëndë dakord për pranimin e certifikatave të produkteve medicinale, gjë që e mundëson normalizimin e tregtisë në fushën e produkteve medicinale.

Në qershor të vitit 2015, palët nga Prishtina dhe Beogradi kanë rënë dakord për themelimin e dy pikë-kalimeve të reja të përkohshme në Kapi/Kapija Vrapqe në jug dhe Rajetiçi/Izvor në veri.

## ***Integrimi i strukturave të sigurisë***

Në fund të muajit mars 2015, në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja dhe pas marrëveshjes së prillit 2013, palët nga Prishtina dhe Beogradi kanë rënë dakord rreth procedurës për integrimin e 483 pjesëtarëve të mbrojtjes civile serbe që veprojnë në veri të Kosovës. Që atëherë është arritur progres i matshëm. Deri më 20 korrik, 105 ish-pjesëtarë të mbrojtjes civile janë integruar në Agjencinë e Kosovës për Menaxhim të Emergjencave dhe në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Progresi për integrimin e pjesëtarëve të tjerë në institucione të ndryshme të Kosovës është në fazë të avancuar.

## ***Drejtësia***

Në shkurt 2015, në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja, palët nga Prishtina dhe Beogradi kanë rënë dakord për zbatimin e dispozitave për drejtësi nga marrëveshja e parë.

Pas shpalljes së vendeve të lira të punës, procesi i integritit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është në vazhdim e sipër.

## ***Njësia e PK për trashëgimi fetare dhe kulturore***

Njësia e PK-së për vendet me trashëgimi fetare dhe kulturore ka themeluar bashkëpunim pozitiv me Kishat Ortodokse dhe Katolike. Në shkurt 2015, Drejtori i Përgjithshëm i PK-së dhe Peshkopi i Rashkës - Dioqezës së Prizrenit, kanë mbajtur takimin e parë për të diskutuar rreth performancës së kësaj Njësie.

Në tetor 2014, një urdhër operativ për ruajtjen dhe mbrojtjen e vendeve me trashëgimi ortodokse serbe ka paraparë që vlerësimet e rreziqeve për vendet me trashëgimi ortodokse të bëhen çdo gjashtë muaj, megjithatë vlerësimi i parë profesional ende nuk është bërë. Ndonëse funksionimi i përgjithshëm i Njesisë për trashëgimi fetare dhe kulturore është në nivel të kënaqshëm, kjo Njësi do të kishte mundur të miratonte një qasje menaxherike më proaktive për përmirësim të efikasitetit të vet.

Njëkohësisht janë duke u ndërmarrë hapa për ngritjen e bashkëpunimit ndërmjet agjencive. Njësia për vende me trashëgimi fetare dhe kulturore ka mbajtur takime me UNDP-në, UNMIK-un, PSBE-në dhe EULEX-in, me qëllim për ta siguruar qëndrueshmërinë e vet dhe për t'i trajtuar disa mangësi logjistike. Kohëve të fundit, PSBE-ja ka miratuar në parim një aplikacion për një projekt njëvjeçar që përfshinë trajnimin e Njesisë për VTFK, dhe për rikthimin dhe mirëmbajtjen e një numri të zgjedhur të vendeve me trashëgimi fetare dhe kulturore. Ky projekt ende gjendet në fazën e fundit të miratimit në Bruksel, dhe do t'i nevojitet më shumë kohë para se të fillojë të zbatohet.

# Lista e akronimeve dhe shkurtesave

|              |                                                                 |
|--------------|-----------------------------------------------------------------|
| <b>AKK</b>   | Agjencia Kundër Korrupsionit                                    |
| <b>PK</b>    | Pikë-kalim kufitar                                              |
| <b>PTH</b>   | Prokuroria Themelore                                            |
| <b>QK</b>    | Qendër Korrektuese                                              |
| <b>ARC</b>   | Agjencia për Regjistrim Civil                                   |
| <b>P</b>     | Pikë-kalim                                                      |
| <b>KSH</b>   | Kryeprokuror i Shtetit                                          |
| <b>QP</b>    | Qendër Paraburgimi                                              |
| <b>DML</b>   | Departamenti për Mjekësi Ligjore                                |
| <b>DP</b>    | Drejtor i Përgjithshëm                                          |
| <b>BE</b>    | Bashkimi Evropian                                               |
| <b>EULEX</b> | Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit               |
| <b>PSBE</b>  | Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian                       |
| <b>NJIF</b>  | Njësia për Inteligjencë Financiare                              |
| <b>LL</b>    | Liria e Lëvizjes                                                |
| <b>QK</b>    | Qeveria e Kosovës                                               |
| <b>SHM</b>   | Shef i Misionit                                                 |
| <b>BSL</b>   | Burg i Sigurisë së Lartë                                        |
| <b>MIK</b>   | Menaxhim i Integruar i Kufirit                                  |
| <b>IB</b>    | Inspektorati i Brendshëm (i Ministrisë së Drejtësisë në Kosovë) |
| <b>PPBI</b>  | Puna policore e Bazuar në Inteligjencë                          |
| <b>DPII</b>  | Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale             |
| <b>BPBSL</b> | Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit          |
| <b>PKK</b>   | Policia Kufitare e Kosovës                                      |
| <b>DK</b>    | Dogana e Kosovës                                                |
| <b>SHKK</b>  | Shërbimet Korrektuese të Kosovës                                |
| <b>KFOR</b>  | Forcat për Kosovën                                              |
| <b>KGJK</b>  | Këshilli Gjyqësor i Kosovës                                     |
| <b>PK</b>    | Policia e Kosovës                                               |
| <b>AKP</b>   | Agjencia Kosovare për Pronë                                     |



|                |                                                                          |
|----------------|--------------------------------------------------------------------------|
| <b>KPK</b>     | Këshilli Prokurorial i Kosovës                                           |
| <b>KKKP</b>    | Komisioni i Kosovës për Kërkesa Pronësore                                |
| <b>DPK MD</b>  | Departamenti i Policisë së Kosovës për Mbrojtjen e Dëshmitarëve          |
| <b>NJPK MD</b> | Njësia e Policisë së Kosovës për Mbrojtjen e Dëshmitarëve                |
| <b>QPM</b>     | Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë                                       |
| <b>PZM</b>     | Plani i Zbatimit të Misionit                                             |
| <b>MPB</b>     | Ministria e Punëve të Brendshme                                          |
| <b>MD</b>      | Ministria e Drejtësisë                                                   |
| <b>MM</b>      | Memorandum i Mirëkuptimit                                                |
| <b>ZAMV</b>    | Zyra Administrative në Mitrovicën Veriore                                |
| <b>QKMK</b>    | Qendra Kombëtare për Menaxhim të Kufirit                                 |
| <b>KKKE</b>    | Koordinatori Kombëtar për Krimet Ekonomike                               |
| <b>KSH</b>     | Kryeprokurori i Shtetit                                                  |
| <b>ODC</b>     | Prokurori Disiplinor                                                     |
| <b>AKP</b>     | Agjencia Kosovare Privatizimit                                           |
| <b>APZH</b>    | Auditim pas Zhdoganimit                                                  |
| <b>IPK</b>     | Inspektorati Policor i Kosovës                                           |
| <b>ERSH</b>    | Ekipi për Reagim të Shpejtë                                              |
| <b>RCHS</b>    | Vendet e Trashëgimisë Fetare dhe Kulturore                               |
| <b>SL</b>      | Sundim i Ligjit                                                          |
| <b>DHPGJS</b>  | Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme                                       |
| <b>SEED</b>    | Shkëmbimi Elektronik Sistematik i të Dhënave                             |
| <b>PSP</b>     | Procedura Standarde e Punës                                              |
| <b>PSRK</b>    | Prokuroria Speciale e Kosovës                                            |
| <b>UNDP</b>    | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim                             |
| <b>UNMIK</b>   | Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë                                 |
| <b>ULV</b>     | Udhërrëfyes për Liberalizim të Vizave                                    |
| <b>WINPRO</b>  | Mbrojtja e Dëshmitarëve në Luftë kundër Krimeve të Rënda dhe Terrorizmit |

# European Union Rule of Law Mission

## *Partnership for Justice*



[www.twitter.com/eulexkosovo](http://www.twitter.com/eulexkosovo)



[www.facebook.com/eulexkosovo](http://www.facebook.com/eulexkosovo)



[www.youtube.com/eulexkosovo](http://www.youtube.com/eulexkosovo)